

STATUTI

I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR I&D ROYAL

NENI 1

THEMELIMI I SHOQERISË DHE BAZA LIGJORE

Sot me datë 15.05.2023 shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **I&D ROYAL sh.p.k.** është themeluar duke u bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare” si dhe në ligjin nr. 9723 datë. 03.05.2007 “Për qëndrën kombëtare të regjistrimit” dhe në përputhje me të, me ortakë të shoqerisë **Z. Astrit Dedaj** me ID J00406112L dhe **Z. Klodjan Bleta** me ID J51024069U

NENI 2

EMËRTIMI

Emërtimi i kësaj shoqerie do të jetë **I&D ROYAL sh.p.k.**

Inicialet e Shoqërisë do të jenë **I&D ROYAL sh.p.k.**

NENI 3

ADRESA E SELISË SË SHOQËRISË DHE SHTRIRJA E AKTIVITETIT

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Shkodër, Golem, Njësia Administrative Rrethina me nr/pasurie 112/8 dhe zone kadastrale 1790.

Shoqëria shtrin aktivitetin e saj brënda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë duke gëzuar të drejtën që të ngre filiale apo zyra përfaqësimi edhe në rrethe të tjera të Republikës së Shqipërisë apo dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 4

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërise do të jetë pa afat të përcaktuar.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqerie është:

Hotel. Bar - restoran.

NENI 6

KAPITALI

Kapitali themelor i shoqerisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë, i barazvlefshëm me 2 kuota. Ortakë të shoqërisë janë:

- Astrit Dedaj me 50% të kuotave
- Klodjan Bleta me 50% të kuotave

NENI 7

TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT, FORMAT

Në rast transferimi të kuotave të kapitalit, me vendim asambleje të ortakeve duhet përcaktuar çmimi i shitjes së kuotave që kërkohet të transferohen nëpërmjet shitjes.

Çmimi i shitjes duhet të vendoset në bazë të vlerës reale të tyre në momentin e dhënieve së të drejtës dhe miratimit të saj nga ana e asamblesë së ortakëve.

Kontrata për transferimin e pjesëve të kapitalit duhet të jetë në formën e aktit notarial, dhe në rast se pronari i ri nuk është ortak i shoqerisë, duhet të deklarohet shprehimisht në kontratë se është njojur me statutin e shoqerisë dhe se është plotësisht dakort me to. Kjo kontratë depozitohet në selinë e shoqërisë.

NENI 8 **TRANSFERIMI TEK PJESTARI I FAMILJES**

Pjesët e kapitalit janë lehtësish të transferueshme tek familjarët, bashkëshortët, prindërit dhe fëmijët.

Nëse një ortak vdes, trashigimtari apo trashigimtarët në rastin e bashkëzoterimit të kuotave dhe trashigimtarët e tij në rast se ky person ishte zotëruesh i vetëm i bashkëzoteruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njojur nga shoqëria si gjëzues i të drejtave mbi kuotën e tij. Pavarsisht parashikimeve të bëra në këtë STATUT, pasuria e ortakut të vetëm nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me personat e tjera.

Personi që fiton të drejten mbi një kuotë në rast të vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga administratorët, mund të zgjedhë të bëhet zotëruesh i kuotës ose të kërkojë rregjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës.

Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të ortakut do të ketë të drejtat që gjëzonte zotëruesi i kuotës, duke përashtuar të drjtën e votës në asamble deri në momentin e rregjistrimit në QKB.

NENI 9 **RRITJA DHE REDUKTIMI I KAPITALIT THEMELOR**

Kapitali themelor i shoqërisë mund të rritet apo reduktohet pa kufizim në çdo moment, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Ortaku nuk është i detyruar ta rrisë vlerën e kontributit të vet mbi shumën, për të cilën është rënë dakord, ose ta shtojë atë, nëse ky kontribut është zvogëluar nga humbjet. Ortaku nuk mund ta zvogëlojë vlerën e kontributit të vet, pa miratimin e ortakëve të tjera. Asambleja mund të vendos reduktimin e kapitalit të shoqërisë brenda limiteve ligjore.

NENI 10 **ORGANET E SHOQËRISË DHE PËRFAQQESIMI**

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

NENI 11 **ASAMBLEJA**

Organi vendimor i shoqërisë është asambleja e ortakëve.

Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 12 **KOMPETENCAT E ASAMBLESE**

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpérblimeve për personat e përmendor në shkronjat c dhe ç të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 13 **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE**

Ortaku ka të drejtë të jetë i informuar në lidhje me administrimin e shoqërisë, të njihet me bilancin vjetor dhe të kerkojë sqarime me shkim nga administratori.

Ortaku gjithashtu ka të gjitha ato të drejta dhe detyrime të tjera që percaktohen në dispozitat ligjore e konkretisht ligji 9901 “Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare” i ndryshuar.

NENI 14 **ADMINISTRATORI**

Administrator i shoqërisë, emëruar për një afat 5 – vjeçar, është *Astrit Dedaj* dhe ka kompetenca të plota në të gjitha vendimmarrjet.

NENI 15
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Kompetencat kryesore të Administratorit:

- kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë së shoqërisë, duke zbatuar politikat e përcaktuara nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqëson shoqërinë
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve, të regjistrave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet këto dokumente asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijon një sistem informimi dhe vlerësimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- raporton në Asamble sipas kërkesave të asamblesë së anëtarëve;
- ka çdo lloj kompetence tjeter të parashikuar në ligj, me përjashtim të atyre kompetencave që sipas ligjit janë atribut i Asamblesë.

Administratorit, të cilit i ka mbaruar mandati i plotë i emërimit, kryen vetëm ato detyra, të cilat janë të nevojshme për përbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e shoqërisë, deri në emërimin e administratorit të ri.

NENI 16
AKTIVITETI USHTRIMOR VJETOR, BILANCI DHE NDARJA E FITIMIT

Viti ushtrimor i aktivitetit të shoqërisë mbylljet me çdo datë 31 Dhjetor.

Në perfundim të vitit ushtrimor, administratori procidon më hartimin e bilancit, llogaritjen e fitimit dhe të humbjes sipas ligjit.

Pas plotësimit të detyrimeve ligjore nenit 77 te ligjit 9901, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të asamblesë së përgjithshme, mund të deklarojnë shpërndarjen e dividentit. Shpërndarja e fitimit do të kryhet në mënyre të tillë:

- a. 20% e fitimit do të shpërndahet në mënyre të barabartë me nga 50% secili ortak.
- b. 80% e fitimit do të shpërndahet në proporcion me kontributin e secilit prej ortakëve në realizimin e fitimit.
- c. Në të njëjtin raport do të shpërndahen edhe shpenzimet.

NENI 17
SHKRIRJA E SHOQËRISË

Shoqëria shkrihet dhe hyn në proces likuidimi për shkaqet e mëposhtme:

1. Përfundimi i afatit të shoqërisë, sipas përcaktiveve të statutit;
2. Vullneti i anëtarëve, i manifestuar nëpërmjet vendimit të asamblesë së përgjithshme;
3. Përbushja e plotë e objektit të shoqërisë ose pamundësia për ta përbushur atë;
4. Zvogëlimi i numrit të anëtarëve nën minimumin ligjor të nevojshëm, për të krijuar një shoqëri, sipas dispozitave të ligjit, nëse numri i nevojshëm i anëtarëve nuk rivendoset brenda një periudhe prej 6 muajsh;
5. Bllokimi i veprimtarisë vendimmarrëse të ndonjërit prej organeve të shoqërisë ose mosushtimi i veprimtarisë së shoqërisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare;

6. Reduktimi i kapitalit të shoqërisë nën minimumin e përcaktuar në ligj, nëse nuk rivendoset brenda një periudhe gjashtëmujore;
7. Nisja e procedurave të falimentimit;
8. Mosushtimi i veprimtarisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare dhe mosnjoftimi i pezullimit të veprimtarisë, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
9. Nëse shoqëria rezulton me humbje për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare me vendim të gjykatës;
- 10.** Për çdo arsyе tjetër, të përcaktuar në ligj.

NENI 18
LIKUIDIMI

Përveç rasteve kur kundrejt shoqërisë është hapur një procedure falimentimi ndaj personit juridik, sipas dispozitave të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar, verifikimi i një prej shkaqeve të përmendura në nenin 15 të këtij Statuti, ka si pasojë hapjen e fazës së likuidimit të shoqërisë në gjendjen e aftësisë paguese.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas vendimit të prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

Çdo person i interesuar ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, nëse paraqet arsyë të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cënohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër.

Likuiduesi emërohet nga gjykata në rastet kur shoqëria prishet me vendim të gjykatës.

NENI 19
DISPOZITAT E FUNDIT

Përsa nuk është shprehur në këtë statut është kompetencë e Asamblesë së Ortakëve.

Ky statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ditë në të cilën shoqëria njihet edhe si person juridik.

ORTAKËT E SHOQËRISË

Astrit Dedaj

Klodjan Bleta